

Presidenti i BSPSH, z. Gëzim Kalaja u takua në zyrat e BSPSH me Sekretarin e Përgjithshëm të “industriAll Europe” të sapo zgjedhur nga Kongresi i II -të në Madrid, z. Luc Triangle. Në këtë takim, z. Triangle u njoh me historinë legjendare të SPMSH-së dhe BSPSH-së në përmbyshjen e diktaturës në Shqipëri. Gjithashtu u informua për kontributin dhe arritjet e SPMSH dhe BSPSH në këto 25 vite. Ndërsa gjatë vizitës në fabrikën e çimentos në Fushë- Krujë z. Triangle u takua me bazën sindikaliste ku pa nga afër frontet e punës, kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë.





